



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-156

Prishtinë, më 7 maj 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 7 MAJ 2014

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Etem Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Jakup KRASNIQI, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 prill 2014,
2. Shqyrtimi i kërkesës për mbajtje të seancës së jashtëzakonshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 prill 2014

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 prill 2014.

2. Shqyrtimi i kërkesës për mbajtje të Seancës së jashtëzakonshme

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Grupi prej 57 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 38 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për mbajtje të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit më 7 maj 2014, në orën 12:00, me këtë rend dite: *Shpërndarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur të nënshkruar nga Grupi prej 57 deputetëve të Kuvendit, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 7 maj 2014, në orën 12:00, me këtë:

Rend dite

1. Shpërndarja e Legjislaturës IV të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 11:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale